



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 126, datë 06.03.2020

PËR
DISA SHTESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
NR.30, DATË 14.02.2019

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në pikën 3 të nenit 4, në pikën 1 të nenit 147, si dhe në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenet 2, 89, 97 dhe 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, bëhen këto shtesa :

Pas paragrafit X/1, shtohet paragrafi X/2 me këtë përmbajtje:

“X/2 Dispozitë për gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar

1. Ky vendim zbatohet edhe për gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar.
2. Gjyqtarët që caktohen në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për çështje gjyqësore të veçanta, përzgjidhen, me short, ndërmjet gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
3. Gjyqtarët që caktohen në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për çështje gjyqësore të veçanta, përzgjidhen, me short, ndërmjet gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe apelit me juridiksion të përgjithshëm, të cilët kanë të paktën 10 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR